



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 415 Akti

Nr. 493 Vendimi  
Tiranë, më 22.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Kliton Spahiu**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78**, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizo shpjegimet, dokumentacionin dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 2.6.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kliton Spahiu, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Kliton Spahiu ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pasi u përzgjedh me shortin e hedhur, më 16.12.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me rregulloren “Procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin ka filluar menjëherë me caktimin me short të trupit gjykues, të përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj.
4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe vendimet dhe dokumentacionet e ardhura nga Këshillit i Lartë Gjyqësor dhe nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, si dhe njëkohësisht anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.
6. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit:

- a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në DSIK, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

7. Në vijim, gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor vënien në dispozicion të raportit profesional të subjektit Kliton Spahiu, i cili nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020, ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2020<sup>1</sup>, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është dënuar përfundimisht për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç-25 i Kodit Penal<sup>2</sup>, duke bërë me dije, gjithashtu, se KLGJ-ja nuk ka ndonjë vendimmarrje lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit Kliton Spahiu.

8. Në datën 18.1.2021, Komisioni u vu në dijeni nga subjekti Kliton Spahiu lidhur me kërkesën e tij drejtuar KLGJ-së, ILD-së dhe për dijeni Komisionit se kishte depozituar një kërkesë me objekt “Kërkesë për të hequr dorë nga detyra e gjyqtarit duke kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit”. Nisur nga kërkesa për dorëheqje e parashtruar nga subjekti, me të cilën vuri në dijeni Komisionin, ky i fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, i kërkoi informacion KLGJ-së si organ kompetent të sqaronte dhe të informonte lidhur me stadin e procedimit të kërkesës për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

9. KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021, ka informuar Komisionin se kërkesa është trajtuar në mbledhjen e tij të datës 1.3.2021 dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.2021, ka vendosur “*Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës për dorëheqje të magjistratit, deri në përfundimin dhe/ose procedimit disiplinor ndaj tij*”, duke bashkëlidhur edhe vendimin e pezullimit.

10. Më tej, në përgjigje të kërkesës nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2021, të Komisionit me objekt “kërkesë për informacion”, drejtuar Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë lidhur me zhvillimin e procedurave të mëtejshme për magjistratin Kliton Spahiu, ky i fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2021, vuri në dispozicion kopje të vendimit nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2021, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Kliton Spahiu dhe propozimin e masës disiplinore ‘shkarkim nga detyra për magjistratin Kliton Spahiu’, të parashikuar nga germa ‘b’, e pikës 2, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga pikat 3 dhe 111, të neneve 104, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>1</sup>Konstatohet se z. Kliton Spahiu është dënuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2020, ndaj vendimit është ushtruar rekurs, çështja regjistruar me nr. \*\*\*, datë 4.12.2020, e cila rezultoi të jetë në status studimit: [http://www.gjykataelarte.gov.al/gil\\_ceshtje\\_detaje.php?caseId\\_sel=2020-03005&ln=Lng1&uni=20211217151520134061106329302729](http://www.gjykataelarte.gov.al/gil_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2020-03005&ln=Lng1&uni=20211217151520134061106329302729)

<sup>2</sup>Neni 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”.

11. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2021, vuri dispozicion vendimin (e shkurtuar) nr. \*\*\*, datë 2.6.2021, për pranimin e kërkesës së ILD-së për *shkarkimin nga detyra të magjistratit Kliton Spahiu, si dhe ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve financiare.*

12. Në vijim të sa më sipërpërkthuar si dhe të dispozitës së pikë 1, të nenit 147, të ligjit nr. 96/2016, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2021, i ka kërkuar informacion KLGJ-së nëse vendimi i shkarkimit të magjistratit ishte ankimuar sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, në Gjykatën Kushtetuese. KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2021, informoi se afati i ankimit për këtë subjekt është katër muaj<sup>3</sup>.

13. Me kalimin e afatit të ankimit, prej 4 muajve, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2021, iu drejtua KLGJ-së duke i kërkuar ta bënte me dije nëse vendimi i shkarkimit nga detyra për magjistratin Kliton Spahiu ishte ankimuar, gjithashtu duke i kërkuar informacion edhe lidhur me vijimësinë e vendimit nr. \*\*\*, datë 1.3.2021, me të cilin ishte njoftuar “*pezullimi i shqyrtimit të kërkesës për dorëheqje të magjistratit*”.

14. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit lidhur me faktin nëse është ankimuar vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>4</sup>, ky i fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, i ka kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit nëse subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe ky i fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2021, bashkëlidhur praktikës, ka informuar se në regjistrin e çështjeve në kuadër të Juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nuk është regjistruar asnjë çështje në lidhje me kërkuuesin Kliton Spahiu<sup>5</sup>.

15. Në kushtet kur më parë, nga KLGJ-ja, Komisionit i ishte vënë në dispozicion vetëm vendimi i shkurtuar nr. \*\*\*, datë 2.6.2021, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2021, i kërkoji vendimin e shkarkimit të arsyetuar, si dhe të informonte lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit Kliton Spahiu.

16. Pas marrjes së kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2021, vuri në dispozicion vendimin e arsyetuar<sup>6</sup>, duke vënë në dukje faktin se vendimi ka marrë formë të prerë, pasi, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nuk është regjistruar asnjë çështje lidhur me kërkuuesin Kliton Spahiu dhe, si e tillë, vazhdon më tej KLGJ-ja, z. Kliton Spahiu *është i shkarkuar nga detyra me vendim të formës së prerë*, dhe si i tillë, rezulton që *i ka mbaruar statusi i magjistratit*, pasi ai mbaron kur shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të gremës “ç”, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>3</sup>KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2021, ka bërë me dije se afati i ankimit për këtë subjekt është 4 muaj nga konstatimi i cenimit dhe, si i tillë, subjekti, në momentin e dërgimit të kësaj shkrese, ndodhej ende brenda afatit të ankimit.

<sup>4</sup>Referojuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021, të KLGJ-së, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>5</sup>Pika 1, e nenit 147, të ligjit nr. 96/2016, “*1. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente*”.

<sup>6</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 2.6.2021, për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Kliton Spahiu ka edhe mendimin e pakicës, të cilët kanë qenë dakord me pranimin e kërkesës për shkarkimin nga detyra, por kanë qenë kundër vendimit lidhur me pikën 3 të tij, që ka të bëjë me ndërprerjen e menjëhershme të pagës së magjistratit dhe përfitimet e tjera.

## II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TE RIVLERËSIMIT

1. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Trupi gjykues konstaton se z. Kliton Spahiu ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
3. Duke pasur në konsideratë situatën faktike të përshkruar më lart, në kuadrin ligjor të zbatueshëm, si dhe nga praktikat e deritanishme orientuese, referuar rasteve të ngjashme<sup>7</sup>, trupi gjykues vlerëson se në referim të germës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në pikën 2/b të nenit 140, përcaktohet në mënyrë eksplicite se gjyqtari shkarkohet nga detyra, ndër të tjera, edhe kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Bazuar kjo në vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2020, ku është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, magjistrati Kliton Spahiu është dënuar përfundimisht me dy vjet burgim<sup>8</sup>, vendim i cili ka marrë formë të prerë në kuptim të përcaktimeve të germës “b”, të pikës 3, të nenit 462 dhe germave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 428, të Kodit të Procedurës Penale.
4. Trupi gjykues, pasi u njoh me të gjithë korrespondencën, vendimin nr. \*\*\*, datë 2.6.2021, të KLGj-së, që ka shkarkuar nga detyra magjistratin Kliton Spahiu, si dhe u vu në dijeni nga ky i fundit se gjyqtari i *shkarkuar nuk ka paraqitur ankim brenda afatit të përcaktuar në ligj në organet kompetente*, mbështetur edhe në faktin se *gjyqtari ka kërkuar të heqë dorë nga statusi i magjistratit dhe nga funksioni i gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Durrës*, në këto kushte dhe, për rrjedhojë, të sa më sipër është konkluduar nga organet kompetente, rezulton se subjekti ka humbur statusin e magjistratit.
5. Referuar kërkesës për dorëheqje të magjistratit që ka kërkuar dorëheqjen nga statusi dhe nga funksioni, në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron në rastet kur *“jep dorëheqjen”*, si dhe në nenin 65, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes *“Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.*

<sup>7</sup>Referojuni vendimit nr. 60/2020 regjistër (JR) nr. 32 i vendimit datë 18.12.2020, datë 14.10.2021, të Kolegjit.

<sup>8</sup>Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2020, ka lënë në fuqi vendimin, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim dhe vendosur magjistratin në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale dhe duke mbajtur kontakte me shërbimin e provës.

*Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit*". Trupi gjykues arrin në përfundimin se nga kjo analizë e përgjithshme juridike dhe nga të gjitha vendimet e disponuara nga organet kompetente lidhur me magjistratin Kliton Spahiu, vlerëson se vendimi për shkarkimin e gjyqtarit ka marrë formë të prerë dhe nuk rezulton të jetë kundërshtuar prej magjistratit në rrugë gjyqësore apo administrative sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në këto kushte, në drejtim të sigurisë juridike dhe të faktit se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit dhe aktualisht asnjë çështje, nuk gjendet e ankimuar nga subjekti në ndonjë gjykatë kompetente<sup>9</sup> për të zgjidhur ndonjë pretendim apo kundërshtim lidhur me vendimin nr. \*\*\*, të datës 2.6.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Për këto arsye dhe shkaqe ligjore duke përfshirë edhe mbarimin e statusit të magjistratit, shoqëruar kjo me faktin se vendimi nr. \*\*\*, datë 2.6.2021, ka marrë formë të prerë, duke pasqyruar kështu dhe efektet juridike përkatëse, pasi është shoqëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë me kushtin e *shkarkimit nga funksioni për përgjegjësi disiplinore*, që përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të germës "ç", të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të konfirmuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet me shkresës nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2021, z. Kliton Spahiu rezulton se i ka mbaruar statusi i magjistratit.

8. Në harmoni me të gjitha sa u përshkrua më sipër, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen.

9. Gjithashtu, referuar Kushtetutës, në pikën 2 të nenit 104 të saj, shkarkimi i gjyqtarit lidhet me dy kategori, të cilat janë: "*Shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskretitojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; dhe kryerjen e një krimi, për të cilin gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë*".

10. Në vijim të arsytimit të kësaj situate dhe rrethanave juridike të përshkruara në arsytimin e këtij vendimi, por edhe në zbatim të dispozitave të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon *pamundësinë në objekt apo qëllim*, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

11. Referuar kësaj dispozite ligjore, si dhe në harmoni me faktin që subjekti i rivlerësimit nuk gëzon më statusin e magjistratit, trupi gjykues vlerëson të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Kliton Spahiu, pa një vendim përfundimtar.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në pikën 2/b, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në germën "ç", të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në

<sup>9</sup>Referojuni praktikës së ardhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kliton Spahiu, pa një vendim përfundimtar, për shkak se ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall sot, në datën 22.12.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Orjanda Liçi*